



Pranuar / Dorezuar Priljenoi/Prudato Received/Delivery	01.11.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstva Org /Unit	SKINSHCK 6809	Shtesa Prilog Appendix 2023	Sasia Kolicina Quantity 114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1167/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar-Kryetare, Arben Mehmeti, Ardita Haxhnikaj-Demi-Anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1167/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë:

\_\_\_\_\_, kundër rezultatit përfundimtar të konkursit për grupin "Specialist i Arsimit në Komune e Pejës, në çështjen juridike, "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.10.2023, morri këtë:

V E N D I M

*Hedhet poshtë si e parakohshme* ankesa me numër A.nr.1167/2023, e datës 18.09.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme/ DMZP-ja me datën 05.05.2023 ka shpallur konkursin për Grup Specialist i të Arsimit, për pozitën e punës Inspektor i Arsimit i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 26.05.2023 deri me datën 05.06.2023. Sipas listës së publikuar në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ankuesi ka kaluar të gjitha fazat e konkursit si dhe sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi është renditur i teti (8) me gjithsejtë 73 pikë.

Ankuesi pas publikimit të renditjes përfundimtare lidhur me konkursin për pozitën "Inspektor i Arsimit", me datën 15.09.2023 ka parashtruar ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme – DMZP, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e ka parashtruar me date 18.09.2023 kurse me datën 28.09.2023 Kryesuesja e Komisionit të pranimit në DMZP ka marr vendim me të cilën ankuesit i ka refuzuar ankesën.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa, kjo e fundit, me datë 26.09.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 6130/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresa me fotografi me korrespondim prej 2 faqeve; E-mailin e datës 18.09.2023 të dërguar nga [redacted] për KPMSHCK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.09.2023 të dërguar nga KPMSHCK për DMZP/MPB; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1107/2023 të datës 26.09.2023 të dërguar nga DMZP/MPB në KPMSHCK; Vendimin me numër 05/151 të datës 12.07.2023; Listën e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00011608; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe kandidatëve të refuzuar për konkursin me numër reference RN00011608; Njoftimin e datës 10.07.2023; Njoftimin e datës 19.07.2023; Vendimin me numër 1408/2023 të datës 11.09.2023; Renditjen përfundimtare të datës 11.09.2023; Konkursin me numër reference RN00011608 të datës 05.05.2023 të shpallur nga MPB; Aplikacionin e kandidatit [redacted] të datës 30.05.2023, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplomën me numër 1201 të datës 23.05.2022; Diplomën me numër 221 të datës 25.01.2011; Vërtetimin me numër 1155/58 të datës 29.05.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 24.05.2023; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Emaili i datës 26.10.2023 i KPMSHCK-se drejtuar DMZP-se; Emaili i datës 27.10.2023 i DMZP-se drejtuar KPMSHCK-se së bashku me dokumentet e bashkangjitura Ankesën e datës 15.09.2023 të ankuesit drejtuar organi të punësimit-DMZP-se dhe Vendimin e datës 28.09.2023 të Kryesueses së Komisionit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted], është e parakohshme, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni i Vlerësimit në intervistën me gojë nuk e ka vlerësuar ankuesin mire pasi që i njëjti i ka dhënë të gjitha pyetjet e sakta.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës gjegjësisht konkursit me numër RN00011608, të datës 05.05.2023 për grupin " Specialist te Arsimit" me titullin e pozitës „Inspektor i Arsimit në SIA në Pejë”, kërkesë për pranim kanë qenë: “Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryerë detyrën përkatëse. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa kërkesat formale janë kërkuar: Diploma e arsimit të lartë me se paku 3 vite të studimeve, Licencën e mësimit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr.40/L-032 për Arsim Parauniversitar

ne Republikanë e Kosovës, si dhe se paku dy vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për Plotësimin e pozitës së lirë të punës, me theks te veçanta përvojë pune ne mësimdhënie.

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesi dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik, ka kaluar te gjitha fazat e konkursit dhe i njëjti sipas renditjes përfundimtare të datës 11.09.2023, është renditur i teti (8) i pa pakënaqur me rezultatet përfundimtare ankuesi me date 15.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Pranimit në DMZP, tutje ankuesi ende pa e marr vendimin e komisionit të pranimit me date 18.09.2023 ka parashtruar ankesë ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. ankesën.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 25 paragrafët 4, 5, dhe 6, ku përcaktohet se: "...4.Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatit e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit. 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje." si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, fillimisht, duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Komisioni i Pranimit, e me tej pas marrjes se vendimit te organit te punësimit apo ne raste të heshtjes administrative, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar afatet ligjor sipas nenit 127 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës rezulton së ankuesi me datë 15.09.2023, ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke kundërshtuar vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit, pra ende pa përfunduara afati ligjor për vendosje të ankesës nga Komisioni i Pranimit, parashtron ankesë (me objekt të njëjtë) në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, nisur nga ky fakt, rrjedhë së ankesa e ankuesit me numer A.nr.1167/2023, e parashtruar me datë 18.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, gjegjësisht Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejueshme ngase nuk ka shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 25 paragrafin 4, 5, dhe 6, të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 16 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk



është përcaktuar ndryshe, dhe si e tillë ankesa e ankuesit është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A nr.1167/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Arkivit të KPMSHCK-së